

PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

FINCA Kosovo

31 DHJETOR 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	1
Pasqyra e pozicionit financiar	6
Pasqyra e Tepricës ose e Deficitit dhe të Ardhurave të tjera Gjithëpërfshirëse	7
Pasqyra e Gjendjes së Fondeve	8
Pasqyra e rrjedhës së parasë	9
Shënimet e pasqyrave financiare	10

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Menaxhmentin e FINCA Kosovo

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të FINCA Kosovo ("Organizata"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2020, pasqyrën e tepricës ose deficitit dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e gjendjes së fondeve dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Organizatës me datën 31 Dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që përfundon në këtë datë, në përputhje me nenin 102, të Ligjit. Nr. 04 / L-093, të datës 12 Prill 2012, "Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare", siç është përshkruar në Shënimin 2 të pasqyrave financiare.

Baza për Opinion

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të) Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Auditorit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEK) që janë relevante në auditimin tonë të pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodin BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, ishin më të rëndësishmet në auditimin tonë të pasqyrave financiare të periudhës aktuale. Këto çështje u adresuan në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi, dhe në forminin e opinionit mbi të, dhe ne nuk shprehim një opinion të veçantë për këto çështje. Secila çështje kryesore dhe adresimi jonë respektiv janë përshkruar më poshtë.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD

AUDIT | TAX | CONSULTING

Provizionimi për humbjet nga kreditë e klientëve	
<p>Huatë neto tek te klientët më 31 Dhjetor 2020 në vlerë prej EUR 45,654,239(31 Dhjetor 2019; EUR 47,454,127), duke përfshirë lejimet për provizionim të humbjeve nga huatë në vlerë prej EUR 1,789,880 (31 Dhjetor 2019; EUR 1,318,801).</p> <p>Ne i referohemi Shënimit 2 "Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit", Shënimi 4 "Vlerësimet Kontabël kritike dhe gjykimet" dhe Shënimi 8 "Huatë ndaj klientëve" për pasqyrat financiare japin informacion të detajuar mbi vlerësimin e provizionit për humbjet e huave dhe paradhënieve të klientëve më 31 Dhjetor 2020.</p>	
Çështje kryesore e auditimit	Si është adresuar çështja në auditimin tonë
<p>Ne jemi përqëndruar në këtë fushë sepse menaxhmenti ushtron gjykim të rëndësishëm, duke përdorur supozime subjektive, kur përcakton kohën dhe shumat e provizionit të humbjeve për huatë. Meqenëse huatë përbëjnë një pjesë të madhe të pasurive të Organizatës, dhe për shkak të rëndësisë së gjykimin të përdorur për vlerësimin e provizioneve individuale dhe kolektive, kjo konsiderohet të jetë një çështje kryesore e auditimit.</p> <p>Rregullorja e BQK-së për rrezikun kreditor kërkon që Organizata të njohë provizione të përgjithshme për portofolion e paklasifikuar (kategoria standarde dhe vrojtuese) bazuar në përvojën e dokumentuar historike të rregulluar për kushtet aktuale dhe perspective të tregut dhe për portofolion e klasifikuar rregullorja përcakton normat minimale të provizioneve, megjithatë Organizata duhet të sigurojë nivele më të larta se minimumi rregullator nëse analiza e rrezikut të huasë në ndonjë ekspozim specifik tregon një nevojë të tillë.</p>	<p>Përgjigja jonë e auditimit përfshin këto vijime:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rishikimi i modelit dhe efektivitetit operativ të kontrolleve kryesore për procesin e monitorimit të performancës së huasë. • Metodologjia e rishikuar e provizionimit për të vendosur inputet kryesore të përdorura në llogaritjen e provizioneve dhe në bazë të mostrës u testuan inputet kryesore të përdorura. • Ne konkretisht kemi testuar përshtatshmërinë e normave "roll rates" të përdorura për të përcaktuar provizionin e humbjeve për portofolion e klasifikuar dhe jo të klasifikuar, i cili përfshin një përmbledhje të metodologjisë së përdorur për ndërtimin e "Roll Rates" dhe një vlerësim nëse të dhënat e mbledhjeve historike që përdoren nga Menaxhmenti janë në bazën e përshtatshme mbi të cilën parashikohen rikuperimet në të ardhmen në mjedisin aktual ekonomik. • Procedurat e kryera për të arritur siguri në saktësinë e procesit të përlllogaritjes së dëmtimit kolektiv përmes rillogaritjes së provizionit bazuar në inputet e audituara. • Në bazë të mostrës kemi testuar huatë që klasifikohen në përputhje me rregulloren e BQK-së për rrezikun e huasë. • Vlerësuam shpalosjet e bëra në raport me rregullat përkatëse dhe standardet e kontabilitetit.

Njohja e të hyrave nga interesi në hua dhe paradhëniet për klientët	
Të hyrat nga interesi dhe të ngjashme për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020 në vlerë EUR 10,150,828 (31 Dhjetor 2019; EUR 10,712,199).	
Ne i referohemi Shënimit 2 "Përmbledhje e politikave të rëndësishme të kontabilitetit", Shënimi 8 "Huatë ndaj klientëve", dhe Shënimi 16 Të hyrat nga interesi të përfshira në pasqyrat financiare ofrojnë informacion të detajuar mbi të hyrat e interesit dhe normat efektive të interesit të huave dhe paradhëniet për klientët.	
Çështje kryesore e auditimit	Si është adresuar çështja në auditimin tonë
<p>Ne jemi përqendruar në këtë fushë kryesisht për shkak të madhësisë së këtij zëri të veçantë të pasqyrave financiare. Për më tepër, në raste të caktuara, norma e interesit efektiv të detyruar mund të mos korrespondojë me normën e interesit kontraktues të huasë, e cila mund të sjellë një kompleksitet shtesë në llogaritje.</p> <p>Rrethanat e tilla lindin kur kushtet kontraktuale përfshijnë opsionet e parapagimit dhe kostot e tjera të transaksionit, të tilla si komisionet, zbritjet ose premiumet, të cilat Organizata i merr parasysh gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit.</p>	<p>Përgjigja jonë e auditimit përfshin këto:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ne kemi bërë rillogaritjen e të hyrave nga interesi në baza mujore. Të dhënat hyrëse, të tilla si shumat kryesore, normat e interesit kontraktual, valutat dhe datat e maturimit u testuan përmes testimit të detajeve dhe gjurmimit të dokumenteve burimore. • Në bazë të mostrës ne kemi testuar të hyrat nga interesi, tarifën e disbursimit dhe interesin e përlogaritur, përmes rillogaritjes dhe përputhshmërisë me dokumente mbështetëse siç janë marrëveshjet e huasë dhe planet e amortizimit.

Theksim Çështje

Ne tërheqim vëmendjen për Shënimin 2 në pasqyrat financiare, i cili përshkruan bazën e kontabilitetit. Pasqyrat Financiare janë përgatitur për të ndihmuar Organizatën në përmbushjen e kërkesave të raportimit financiar të Nenit 102, të Ligjit Nr. 04 / L-093, datë 12 Prill 2012, "Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare" referuar më sipër. Si rezultat, pasqyrat financiare mund të mos jenë të përshtatshme për një qëllim tjetër. Raporti i auditorit tonë është vetëm për informacionin dhe përdorimin nga Organizata dhe Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe nuk duhet të përdoret nga palë të tjera përveç Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Çështje tjera

Organizata përgatit një grup të veçantë të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, mbi të cilin ne lëshojmë një raport të veçantë të auditorit për menaxhmentin e FINCA Kosovo.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe e Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me nenin 102, të Ligjit Nr. 04 / L-093 "Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare" siç detajohet në Shënimin 2 të pasqyrave financiare dhe për një kontroll të tillë të brendshëm siç përcakton menaxhmenti është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që janë të pastra nga keq deklarimet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Organizatës për të vazhduar aktivitetin e sajë në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si dhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të biznesit, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur menaxhmenti ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër reale përveçse më lartë.

Të ngarkuarit me qeverisje janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë të liruara nga keqdeklarimi material, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, dhe të lëshojmë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA do të zbulojë gjithmonë një keqdeklarim material kur ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i mashtrimit ose i gabimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, mund të pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, planifikojmë dhe kryejmë procedura të auditimit që u përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim evidencat të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë bashkëpunim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime ose mbizotërim të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Organizatës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera si edhe shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri me datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Organizatës për vijimësi.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, dhe nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç çështjeve tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë cdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne gjithashtu iu deklarojmë personave të ngarkuar me qeverisjen se ne jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike lidhur me pavarësinë, dhe iu komunikojmë atyre të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera që arsyeshëm mund të mendohet se cenojnë pavarësinë tonë dhe, aty ku është e aplikueshme, marrim masat mbrojtëse përkatëse.

Nga çështjet e komunikuar me personat e ngarkuar me qeverisjen, ne përcaktojmë ato çështje që kishin më shumë rëndësi në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për këtë arsye janë çështjet kryesore të auditimit. Ne i përshkruajmë këto çështje në raportin tonë të auditorit.

Raport për Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore siç kërkohet nga udhëzimi administrativ nr. 02/2019

Takimi i Bordit të FINCA Kosovo na ka caktuar më 29 Qershor 2020 si auditorë të Organizatës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2020. Angazhimi ynë i përgjithshëm i pandërprerë është dy vjet.

Ne konfirmojmë që:

- Opinioni ynë i auditimit për pasqyrat financiare të shprehura këtu është në përputhje me raportin shtesë për komitetin e auditimit të Organizatës, të cilin ne e lëshuam më 11 Mars 2021.
- Ne nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo-audituese të referuara në Nenin 5 (1) të udhëzimit administrativ nr 02/2019 dhe se kemi mbetur të pavarur nga Organizata në kryerjen e auditimit.

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k

Prishtinë, Republika e Kosovës

18 Mars 2021

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Sadik Berisha'.

Sadik Berisha

Partneri i Angazhimit

FINCA Kosovo
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 Dhjetor, 2020

Shënime	Më		
	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019	
	(në EUR)	(në EUR)	
PASURITË			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	6	4,859,161	3,049,205
Depozitat	7	1,500,717	-
Huatë te klientët	8	45,654,239	47,454,127
Parapagimet dhe pasuritë tjera	9	167,117	258,373
Pasuritë e paprekshme	10	6,853	12,821
Prona dhe pajisjet	11	435,786	375,387
E drejta e përdorimit të pasurisë	12	1,686,915	1,407,042
Gjithsej pasuritë		54,310,788	52,556,955
DETYRIMET			
Huazimet	13	34,600,695	36,087,909
Detyrimet tjera	14	828,340	950,997
Detyrimet e qirasë	12	1,758,487	1,447,743
Gjithsej detyrimet		37,187,522	38,486,649
GJENDJA E FONDEVE			
Kapitali i dhuruar	15	4,656,887	4,656,887
Teprica e mbajtur		12,466,379	9,413,419
Gjithsej gjendja e fondeve		17,123,266	14,070,306
Gjithsej detyrimet dhe gjendja e fondeve		54,310,788	52,556,955

Autorizuar për lëshim nga menaxhmenti i FINCA Kosovo më 4 Mars 2021 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:


Ardian Kastrati
Drejtor Ekzekutiv


Endrit Duraku
Drejtor Financiar

Shënimet shoqëruese nga 6 deri 25 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

FINCA Kosovo

Pasqyra e tepricës ose e deficitit dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020

Shënime	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020 (në EUR)	Per vitin që Përfundon më 31 Dhjetor 2019 (në EUR)
Të hyrat nga interesi dhe të ngjashme	16	10,150,828
Shpenzimet e interesit dhe të ngjashme	16	(1,948,483)
Neto të hyrat nga interesi		8,202,345
Provizionimi për humbjet nga kreditë	8	(944,238)
Interesi neto mbi të ardhura pas humbjeve nga provizionime të huave të klientëve		7,258,107
Të hyrat të tjera operative	17	452,914
Shpenzime për personelin	18	(2,429,078)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	19	(1,859,562)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	10,11,12	(378,714)
Rezultati nga transaksionet në kurset e këmbimit	20	(9,942)
Të hyrat (shpenzimet) e tjera jo-operative neto	21	19,235
Suficiti për vitin		3,052,960
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse		-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		3,052,960
		-
		3,689,185

Shënimet shoqëruese nga 6 deri 25 janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare.

FINCA Kosovo
Pasqyra e Gjendjes së Fondeve
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020

	Kapitali i dhuruar	Teprica e mbajtur	Gjithsej Gjendja e Fondeve
	(në EUR)	(në EUR)	(në EUR)
Gjendja më 1 Janar 2019	4,656,887	5,724,234	10,381,121
Suficiti për vitin	-	3,689,185	3,689,185
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	4,656,887	9,413,419	14,070,306
Suficiti për vitin	-	3,052,960	3,052,960
Gjendja me 31 Dhjetor 2020	4,656,887	12,466,379	17,123,266

Shënimet shoqëruese nga 6 deri 25 janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare

FINCA Kosovo
Pasqyra e rrjedhës së parasë

Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020

Shënime	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2020 (në EUR)	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2019 (në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Teprica për vitin	3,052,960	3,689,185
<i>Rregullimet për vitin:</i>		
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	10,11,12 378,714	316,018
Humbja nga rënia në vlerë e huave	8 944,238	797,810
Të hyrat nga interesi	16 (10,150,828)	(10,712,199)
Shpenzimet e interesit	16 1,948,483	2,095,657
Neto të hyrat tjera jo operative	(19,235)	(134,549)
Këmbimi valuator	9,942	12,657
	(3,835,726)	(3,935,421)
Rritja e huasë për klientët	8 1,342,703	(7,439,573)
Zvogëlimi në parapagime dhe pasuritë tjera	(90,541)	92,060
Rritja në të ardhurat e shtyra	8 (28,960)	144,385
Rritja në detyrimet tjera	14 (122,657)	(76,428)
Interesi i pranuar	10,181,073	10,673,930
Interesi i paguar	(1,922,913)	(2,106,026)
Paraja neto nga aktivitetet operative	5,522,979	(2,647,073)
Rrjedha e parasë nga aktiviteti investues		
Rritja e depozitave me afat	7 (1,500,000)	-
Blerja e pronës dhe pajisjeve/ pasuritë me të drejtë përdorimi	11,12 (713,023)	(289,487)
Blerja e pasurive të paprekshme	10 -	(9,644)
Rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet e investimeve	(2,213,023)	(299,131)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare		
Kreditë e marra nga huadhënësit	13 -	16,500,000
Kthimi i huave dhe detyrimeve ndaj huadhënësve	13 (1,500,000)	(12,559,958)
Rrjedha e parasë e përdorur nga aktivitetet financiare	(1,500,000)	3,940,042
Zvogëlimi neto në para dhe ekuivalentet e parasë	1,809,956	993,838
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fillim	3,049,205	2,055,367
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e parasë në fund	6 4,859,161	3,049,205

Shënimet shoqëruese nga 6 deri 25 janë pjesë përbërëse të pasqyrave financiare.